



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 13 qershor 2013, pas zhvillimit të procedurës së votimit për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, mori këtë:

V E N D I M

1. Kandidatët e propozuar për anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, znj. Drita Lulaj-Berisha dhe z. Ilmi Alili nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.
2. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerr shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtarit, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë, në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 04-V-634
Prishtinë, më 13 shtator 2013

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të Pavarur për Media,
- Administratës së Komisionit të Pavarur për Media,
- Komisionit ad hoc,
- Arkivit të Kuvendit.